

KOMUNA E GJAKOVES
DREJTORIA PER BUXHET DHE FINANCA

RAPORT MBI ORGANIZIMIN E DEGJIMEVE BUXHETORE : 2017- 2019 ME PUBLIKUN

Konform Ligjit Mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe Qarkoreve Buxhetore nr. 2017/01/02, të lëshuar nga Ministria e Financave (MF), Komuna e Gjakovës ka organizuar dëgjimet buxhetore 2017-2019 me publikun duke filluar nga dt. 14.09.2016 deri me dt. 21.09.2016, në Rajonin e Rekes së Keqe, Dushkajës, Hasit, Rrekës së mirë dhe qytetin e Gjakovës.

1. Dëgjimi buxhetor me publikun në DOBLIBARE me dt. 14.09.2016, nga ora 16 - 17,30

Banoret e këtij lokaliteti –fshatit të Doblbares falënderuan për organizimin e këtij dëgjimi buxhetor nga ana e Komunes-perfaqësuesve të saj si dhe për parashikimin e investimeve kapitale për rrugën në Doblbare për vitin buxhetor 2017, në vlerë prej 24.000 €, si dhe për vitin 2018 në vlerë prej 220.000 €, dhe për 2019 në vlerë prej: 354,762 €, por kërkuan që për vitin 2017 të ketë një shumë më të madhe të investimit nga Komuna për shkak se vetëm komuniteti ka participuar në vlerë prej: 24.000 €.

Përfaqësuesit e fshatit Vraniq kërkuan të përmirësohet ndriçimi publik, si dhe ndërtimin e një rruge në fshat si dhe një rrugë prej afro 1 km që lidh fshatin Bordosane –Rezine.

Banoret e fshatit Doblbare si gjithë Rajonet tjera rurale të komunës së Gjakovës kanë përfituar nga subvencione falënderuan se edhe fshati Doblbare ka pasur 8 përfitues të subvencioneve

2. Dëgjimi buxhetor me publikun në CERMJAN me dt. 14.09.2016, nga ora 18 – 19

Banoret e Bashkësisë lokale të Cermjanit patën shumë kërkesa për investime kapitale dhe ceken sidomos gjendjen e keqe të kanalizimeve-ujrave të zeza meqenëse ato po vërshojnë mbi sipërfaqe të tokës dhe se ka rrezik për përhapjen e ndonjë epidemie, këtë shqetësim e kanë edhe fshatrat tjera të kësaj ane.

Kërkesa e fshatit Cermjan është që të ndërtohet kanalizimi i ujerave të zeza, pastaj ndriçimi publik në disa pjesë të fshatit si dhe të ndërtohet një rretherrrotullim në fshat për shkak se aty është shkollë afër rrugës dhe ka qarkullim të nxënësve që shkojnë në shkollë dhe rrezikohen në komunikacion.

Përfaqësuesit e fshatit Zhabel dhe Gergoc nuk ka investime, në Zhabelin plakë është investuar në një rrugë për vitin 2017, në vlerë prej 70.000 €, por në Zhabelin e ri jo.

Banoret e këtyre lokaliteteve ankohen për shkak të mungesës së rrymës si dhe dëmtimit të shtyllave elektrike, por kjo kompetencë është e KEDS-it, derisa mirëmbajtjen e ndriçimit dhe pagesën e shpenzimeve e bën Komuna.

Poashtu edhe banorët e fshatit Meqe u ankuan për mungesë të investimeve publike në këtë fshat dhe sidomos ndriçimit publik.

3. Dëgjimi buxhetor me publikun në BL në Ponoshec me dt. 15.09.2016, nga ora 16 – 18

Banoret e kësaj BL dhe fshatrave për rrethë kërkesë kryesore kanë ujësjellësin për 14 fshatrat e Rekes së Keqe i cili projekt ka filluar që para disa viteve dhe ka mbetur pa u realizuar për shkak të pengesave të ndryshme dhe mungesës së mjeteve. Ky burim i ujit vjen nga bjeshkët e Junikut dhe përshkon disa lokalitete por siç duket më në fund edhe me investimet e qeverisë së Zvicrës, asaj të Komunës e më gjere shpresojnë banoret e kësaj ane se do realizohet brenda 2 viteve.

Poashtu mungese është edhe kanalizimi i ujërave te zeza dhe se gjendja ne këtë aspekt është e keqe. Kërkohej qe te vazhdoj asfaltimi i rrugëve ne fshatin Ponoshec i cili ka filluar vjet derisa sivjet akoma nuk ka vazhduar asfaltimi i saj sepse është ndërtua vetëm një segment dhe kërkohej qe ai projekt te kryhet këtë vit mundësisht.

Poashtu kërkohej te ndërtohet një rrugë prej 700 m, ne një lagje Krazhnje te fshatit Shishman. Kërkohej te fillohet me ndërtimin e shkollës fillore ne Ponoshec, si dhe ndërtimi i shtëpisë se kulturës e cila është djegur gjate luftës.

Kërkesë ka edhe per zhavorrimin e rrugës se Morinës meqenëse është ne gjendje te keqe.

4. Dëgjimi buxhetor me publikun ne BL ne Molliq me dt. 15.09.2016, nga ora 18 – 19

Banoret e fshatit Molliq kërkojnë qe te ndërtohet një rrugë –trotuar për rrethe lokalitetit te shkozës për nxënësit e fshatit Botushe qe shkojnë ne shkolle ne Molliq, si dhe rrugët e fshatit te asfaltohen apo ndërtohen me kubeza.

Poashtu është kërkuar qe te shtrohet rruga me zhavorr nga fshati Botushe ne drejtim te fshatit Nivokaz , si dhe shtruarja me zhavorr e rrugës nga Varrezat e Koshares e tutje per ne bjeshke, Fshati Molliq ka kërkesa për ndërtimin e kanalizimeve te ujerave te zeza, si dhe për ndërtimin e kanaleve për ujitje te fushave-arave.

5. Dëgjimi buxhetor me publikun Gjakove-Sallën e Kuvendit me dt. 19.09.2016, nga ora 10-11,20

Kërkesa kryesore ka pasur rrethe ndërtimit dhe zgjerimit te kanalizimeve, ujësjellësve, ndërtimit te rrugëve, trotuareve dhe te tjera te ndryshme.

Është kërkuar qe te përfundoj se ndërtuari rruga “Fehmi Agani” ne qytet , e cila rrugë ka filluar qe nga viti 2014, pastaj një banor i fshatit Ramoc, kërkoj qe te vazhdoi asfaltimi i rrugës Ramoc-Korenice e cila vetëm është e parapare për ndërtim ne vitin 2017 dhe 2018, pastaj kërkohej te përfshihet rruga Pjetershan-Dol-Kushavec. Poashtu kërkohej ndërtimi i nje ure ne Kushavec e cila është e drurit dhe gjendje te keqe.

U kërkuar qe te vazhdohet me ndërtimin e ujësjellësit ne Reken e Keqe si dhe ndërtimit te kanalizimit te ujërave te zeza

Përfaqësuesit e fshatit Lug bunar, kërkuar qe te rregullohet kanalizimi ne këtë fshat meqenëse as me zhavorr nuk është shtruar deri me tani.

Përfaqësuesit e BL- te –IV- ne qytet kërkuar qe te ndërtohet rruga Xhemajl Avdullahu ne gjatësi prej: 300 m.

Përfaqësuesit e BL-9, ne qytet kërkuar investime për ndërtimin e rrugëve ne këtë lokalitet si “ Minatori” “Jahe Salihu” , rrjetin elektrik te ndriçimit etj.

Përfaqësuesit en BL- 8 poashtu kërkuar rregullimin e lumit Krena, si dhe ndërtimin e rrugës “Dëshmoret e Ponoshecit” te parku i mëhallës Gece me e shtrua me kubeza.

6. Dëgjimi buxhetor me publikun ne Dujakë me dt. 20.09.2016, nga ora 16-18

Banoret e kësaj Bashkësie Lokale kërkojnë investime për kanalizim për shkak se ujerat e zeza po dalin ne sipërfaqe dhe ekziston rreziku i infektimit me ndonjë epidemi, rruga është e keqe për ne fshatin Do brigje – rrezik për nxënësit meqenëse mungon një trotuar pre nxënësit dhe rrugëtarët

Rruga qe duhet ndërtua ne këtë fshat është ne një gjatësi prej 1,8 klm dhe ku lidh këtë fshat me atë te Gramaqelit. Shtyllat e rrymës janë te dobëta dhe rrezik me ra ne toke.

Poashtu edhe ne fshatin Firaje kanalizimi eshte ne gjendje shume te keqe.

Përfaqësuesit e fshatit Hereq kerrrkuan ujësjellës sepse furnizohen me uji te puseve-bunarëve , pastaj ndërtimin e kanalizimit per një lagje prej 15 shtëpive te Hereqit.dhe ndërtimi i një pjese te trotuarit afër rrugës per te shkua nxënësit ne shkolle, si dhe zhavorrimin e rrugës ne fshat prej 700 m.

Poashtu ne Dujake kërkohet një trotuar afër rrugës për nxënësit te cilët shkojnë asfaltit deri te shkolla fillore.

7. Dëgjimi buxhetor me publikun ne Skivjan me dt. 20.09.2016, nga ora 18-19

Përfaqësuesit e fshatit Palabardhe dhe 2 Novosellave kerkojn ndertmin e kanaleve te ujërave te zeza sepse nuk kane fare.

Kërkohet ndërtimi i rrugës me asfalt ne fshatin Bitesh.

Banoret e fshatit Skivjan me me se 500 banor kërkojnë qe te përfundohet me ndërtimin e kanalizimit ujërave te zeza, pastaj rruga deri te varrezat, si dhe te vazhdohet me asfaltimin e rrugëve ne Skivjan te cilat kane mbetur ne gjysme, pastaj trotuaret e rrugës për kalimin e nxënësve, pastaj kanale për ujitjen e tokave bujqësore sepse kemi shume nevojë .

Fshati Planqor kërkon kanale te ujitjes se tokave meqenëse disponon 120 ha tok te pa ujitur fare pre mungese te kanaleve.